



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA LIPJAN
OPSTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Nr: 03-111/01-22970
Datë: 07.05.2025

DREJTORATI PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE-
QENDRA KRYESORE E MJEKSISË FAMILJARE

Bazuar ne nenin 80 dhe 81 të Ligjit për Zyrtarë Publik nr. 08/L-197, neni 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-121, Rregullore (QRK) Nr.30/2024 për Procedurën e Pranimi të Nëpunësve të Shërbimit Publik në Sektorin e Shëndetësisë, neni 49 pika 49.2 të Statutit të Komunës së Lipjanit, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale shpall:

K O N K U R S
Për plotësimin e vendeve të punës

Një (1) Shef/e i/e Sektorin e Urgjencës në QKMF-ë Lipjan

Detyrat dhe përgjegjësitë për Shef/e i/e Sektorit të Urgjencës:

1. Është përgjegjës për organizimin punës në njesinë e Urgjencës në QKMF, përgatit orarin e stafit profesional të urgjencës siq janë mjek dhe infermier dhe e dërgon për aprovim te Drejtori i QKMF-se po ashtu njofton Sektorin e Personelit në QKMF për planet e pushimeve vjetore të mjekeve dhe infermiereve.
2. Organizon dhe mbikëqyrë punën në urgjencën mjekësore të QKMF-se të mjekve dhe të infermiereve përcjell zbatimin e planit planit emergjent, planifikon dhe furnizon emergjencën me barna dhe mjete tjera nga barnatorja qendrore dhe depo e QKMF-se.
3. Përgatit raport me shkrim për shërbimet që bëhen dhe është përgjegjës për përcjelljen e shpenzimit të barnave dhe materialit tjetër shpenzues duke dërguar raport me shkrim Drejtorit të DSHPS, QKMF-se.
4. Përgjigjet Situatave emergjente dhe gjendjeve të jashtëzakonshme në çdo kohë dhe kërkon mbështetje në rast të situatave emergjente nga ana e shefit të mjekve në QKMF dhe përmes Drejtorit organizon mbulimin e njësive Emergjente me mjek familjar ose të tjer.
5. Merr pjesë në mbledhjet të cilat i fton Drejtori e në të cilat shqyrtohen tema të ndryshme profesionale apo çështje organizative në nivel të QKMF-se.
6. Merret me përparimin, parandalimin, mjekimin, shërimin dhe rehabilitimin që kanë të bëjnë me sëmundjet, çrregullimet dhe me lëndimet (zbatimin e konceptit të mjekësisë familjare) edukimin shëndetësor imunizimin dhe vaksinimin, përcaktimin e diagnozës fillestare dhe kujdesin elementar shëndetësor duke përfshirë edhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike, udhëzon të specialisti konsultat në përputhje me sistemin e referimit.
7. Mban përgjegjësi për kontrollimin hulumtimin diagnostifikimin trajtimin këshillimin përcjelljen e vazhdueshme të pacientit, pa marrë parasysh moshën apo gjininë dhe po ashtu për saktësinë e të dhënave të regjistruara në dokumentacionin dhe evidencën shëndetësore gjatë ofrimit të shërbimeve shëndetësore, që përmbajnë të dhëna për identitetin personal të pacientit, diagnozën dhe udhëzon infermieret për asistim.
8. Raporton për shërbimet të tij, Drejtorit duke respektuar kodin etik dhe mos cenuar të drejtat e pacientit dhe duke siguruar fshehtësinë profesionale dhe është detyrë të mbledh të dhënat shëndetësore dhe të raportojë në raporte mujore.

9. Merr pjesë ne mbledhjet te cilat i fton Drejtori e ne te cilat shqyrtohen tema te ndryshme profesionale apo çështje organizative ne nivel te QKMF-se.
10. Shefi i njësisë së Urgjences organizon dhe planifikon per stafin profesional mjek dhe infermier për vijuar ne edukimin e Vazhdueshëm Profesional te organizuar ne QTMF dhe bene vlerësim te specifikuar për nevojat për trajnimin dhe zhvillimin profesional përmes koordinorit te QTMF ose Drejtorit te QKMF-se dhe trajnimet e organizuara nga QZHM-F-MSH.

Kushtet dhe kriteret për Shef/e i/e Shef/e i/e Sektorit të Urgjencës:

- Diploma Universitare-Fakulteti i Mjekësisë drejtimi i përgjithëshëm-specilist i mjekësis familjare.
- Licenca e Punës-valide
- Certifikata Shëndetësore jo me e vjeter se gjashtë muaj
- Certifikata që nuk është nën hetime nga Gjykata Themelore në Prishtinë Dega në Lipjan jo me e vjeter se gjashtë muaj.
- Vërtetimi i provojës së punës së paku 3 vite
- Vërtetimi nga Policia që nuk është nën hetime jo me e vjeter se gjashtë muaj
- Letërnjoftimi kopje.

Aftësitë:

- Të ketë aftësi komunikimi
- Të ketë zotësi të plotë veprimt, sipas, legjislacionit në fuqi.
- Të ketë aftësi për udhëheqjen e punës i pavarur duke respektuar Ligjin si dhe etikën
- Të ketë aftësi në organizimin e punës dhe në kryerjen e detyrave të përshkruara më lartë
- Të ketë shkathtësi dhe kualitete personale.
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (vërtetimi nga punëdhësi).

Paga mujore për Shef/e i/e Sektorin të Urgjences QKMF-ë Lipjan:

Koeficienti: Klasa H-7 koeficienti 12.5

Kohëzgjatja e kontratës me kohë të caktuar mandat 4 vite.

Puna Provuese gjashtë muaj (6)

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi është i hapur 30 ditë kalendarike, e drejta për aplikim nga data 08.05/2025 deri me 06.06/2025 që konsiderohet si dita e fundit e konkurrimit.

Paraqitja e Aplikacioneve:

Aplikacionet mund të merren në mënyrë fizike në zyrën për shërbime me qytetarët në Komunën e Lipjanit sporteli nr. 3 dhe dorëzohen në të njëjtën sportel bashkë me dokumentet e kërkuar në konkurs.

Kandidatat të cilet kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Kosovës duhet që diploma e tyre të jetë e njohur (nostifikuar) nga Ministria e Arsimit Shkences dhe Teknologjisë.

Vërejtje:

Dokumentet e dorëzuara duhen të janë kopje të noterizuara (Diploma dhe Licenca) dhe ato nuk kthehen, ndërsa aplikacionet e pa kompletuara dhe pas afatit nuk do të shqyrtohen, **te gjitha njoftimet dhe rezultatet shpallen në web faqen e Komunës <https://kk.rks-gov.net/Lipjan> dhe në tabelën e shpalljeve të Komunës.**

**Drejtori i DSHPS-së
Shkelzen Hajdini**

